



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 67, dt. 03.04.2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 03.04.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikonstruksion i rrugës kryqëzim me rrugën nacionale (Postbllok)”, Gjirokastrë, (në projekt të mos merret për shqyrtim ndërhyrja në Sheshin e Çerçizit) me këto vërejtje:

Në ato pjesë ku projekti cënon disa objekte monument kulture kategori II, të merren masa për ngushtimin e trotuarit në projekt për të shmangur dëmtimin e objekteve.

Për segmentin e rrugës që cënon objektin e Ish Burgut, projekti të mos ndryshojë.

Bashkia të depozitojë në IMK projektin e azhornuar me vërejtjet e mësipërme.

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI